



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 514/1 Prot.

Tiranë më 22.05.2020

Lënda: Përgjigje kërkesës tuaj për mendim

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

Për dijeni: **MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka administruar kërkesën tuaj nr. 814 prot., datë 08.05.2020, në lidhje me mbështetjen për prodhimin e statistikave zyrtare nëpërmjet kontaktimit të abonentëve të telefonisë celulare në Shqipëri, për shkak të pamundësisë së vijimit të anketimeve derë më derë, si pasojë e gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga virusi COVID-19.

Referuar shkresës kuptojmë se në kuadër të prodhimit të statistikave zyrtare kërkohet akses në informacionin mbi abonentët e telefonisë, por pa specifikuar konkretisht kategoritë e të dhënave personale. Referuar qëllimit që kërkohet të arrihet, gjykojmë se kërkohet akses në emrat, mbiemrat dhe numrat e telefonit të abonentëve përkatës.

Kërkesa juaj për akses bazohet në nenin 30 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, duke përmendur edhe detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit në zbatim të nenit 31 të tij. Nga analiza e nenit 30 dhe shtojcës 1 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, vlerësojmë se bëhet fjalë për të dhëna statistikore që lidhen me disa fusha të përpunimit statistikor (ndër të tjera, statistika demografike dhe sociale, ekonomike, sektoriale, etj.).

Ju bëjmë me dije se, në çdo rast, vlerësimi mbi ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale (duke përfshirë çdo lloj veprimi me të dhënat personale, aksesin, mbledhjen, ruajtjen, etj.) duhet të bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, si dhe gjithashtu, sipas dispozitave të

legjislacionit sektorial që rregullon veprimtarinë e palëve të përfshira në një përpunim të caktuar të të dhënave personale.

Kështu, përpunimi i të dhënave personale duhet mbështetur në parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit sipas parashikimeve të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Sa i përket kriterëve ligjore të përpunimit, është e rëndësishme të evidentojmë se me qëllim që të legjitimohet aksesimi në të dhënat mbi abonentët e telefonisë celulare është e nevojshme që të plotësohet njëri nga kriteret ligjore të përpunimit. Në rastin konkret, kërkesa juaj mund të arsyetohet në përputhje me shkronjat "ç" dhe "d" të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, si dhe në pamundësinë për mbledhjen e informacionit statistikor derë më derë, si pasojë e gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga virusi COVID-19.

Nga ana tjetër, nga analizimi i dispozitave ligjore të posaçme të ligjit nr. 17/2018 "*Për statistikat zyrtare*", nuk identifikojmë parashikime specifike sa i përket metodologjisë/mënyrave të përfundimit të informacionit statistikor (përfshirë këtu, mbledhjen për këtë qëllim të të dhënave të abonentëve të telefonisë celulare dhe aksesimi në këto kategorie të dhënash personale), pavarësisht garancive në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, të listuara në nenin 31 të ligjit në fjalë.

Rrjedhimisht, Zyra e Komisionerit vlerëson se neni 30 i ligjit nr. 17/2018 "*Për statistikat zyrtare*" nuk mund të shërbejë si bazë për akses të drejtpërdrejtë në të dhënat personale të abonentëve të operatorëve të telefonisë celulare, pa përcaktuar, më parë, qartë dhe saktësisht kategoritë përkatëse të subjekteve të të dhënave, prej të cilëve synohet të përftohet informacioni statistikor i kërkuar.

Kjo kërkesë parakushtëzohet, veçanërisht, nga parimet e mjaftueshmërisë dhe proporcionalitetit të përpunimit të të dhënave personale, të parashikuar në nenin 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar. Gjithashtu, të dhënat personale mund përpunohen vetëm për atë kohë sa është e nevojshme për realizimin e qëllimit të përpunimit, si dhe për atë kohë sa ekzistojnë faktorët/rrethanat konkrete objektive që justifikojnë një përpunim të tillë.

Më tej, adresimi korrekt i kërkesës suaj, në kontekstin e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale të kërkuara nga institucioni juaj, me qëllim përbushjen e detyrimeve dhe ushtrimin e kompetencave të tij ligjore përveç dispozitave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet vlerësuar edhe në kuadër të legjislacionit sektorial që rregullon fushën e komunikimeve elektronike. Konkretisht, dispozitat e ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 "*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Rrjedhimisht, nevojitet që të vlerësohet nëse legjislacioni i sipërpërmendur (ligji specifik dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, përfshirë këtu, por pa u kufizuar, disponimet juridiko-administrative të autoritetit rregullator) përmban dispozita të posaçme që

mundësojnë aksesin e plotë apo të pjesshëm në kategoritë e të dhënave personale të kërkuara nga Instituti i Statistikave, për qëllime të ushtrimit të përmbushjes së detyrimeve të tij ligjore.

Gjithsesi, nëse sa parashtruar më sipër rezulton e konfirmuar nga legjislacioni sektorial që rregullon komunikimet elektronike, atëherë vetë Instituti i Statistikave dhe kontrolluesit përkatës janë të detyruar të veprojnë në përputhje me parimet e nenit 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, duke garantuar, ndër të tjera, që të dhënat personale të mos përpunohen në tejkalim të sa është e mjaftueshme dhe proporcionale për qëllimin e përpunimit, si dhe vetëm përpunimi të realizohet për aq kohë sa është e nevojshme për realizimin e qëllimit të tij, por, në çdo rast, deri në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore e shkaktuar nga përhapja e COVID-19. Në fund të kësaj periudhe, të dhënat e përpunuara duhet të fshihen/shkatërrohen.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

